

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 1.9.2022, “Për miratimin e ndryshimeve në rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 20.9.2022, bëhet korrigjimi në pikën 9 të tij, si më poshtë vijon:

Neni 9, pika 1.2, germa “b” ishte:

“vërtetimin e gjendjes gjyqësore për shoqërinë, administratorin/administratorët e saj;”.

Neni 9, pika 1.2, germa “b” bëhet:

“vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për shoqërinë, administratorin/administratorët e saj;”.